



## Shërbimit mjekësore

Kush sëmuret apo ka një aksident, duhet në të shumtën e rasteve s`pari të shkoj te mjeku familjar. Te sëmundjet e lehta apo aksidentet njeriu merr ndihmë edhe në barnatore. Vetëm te aksidentet vërtetë të rënda duhet njeriu të shkoj direkt në spital.

### Barnatoret

Barnatoret shesin barna për të cilat duhet të kesh detyrimisht (receipt prej mjekëve) dhe të gjitha barnat e tjera. Te një sëmundje e lehtë propozohet, që njeriu të shkoj më parë në barnatore. Farmacistja dhe farmacisti janë të arsimuar mirë dhe këshillojnë klientet dhe klientët e tyre. Një barnatore për raste emergjente është çdo herë e hapur, kështu njeriu merr edhe në raste emergjente barna. Se cila barnatore për raste emergjente është e hapur, e kupton njeriu përmes këtyre numrave të telefonit:

- Bern: 0900 98 99 00 (0.98 FR/min.)
- Biel: 0842 24 24 24
- Thun: 0900 36 36 36 (0.88 FR/min.)

### Mjeku familjar / mjeku i fëmijve

Në Zvicër e kanë shumë persona një mjek familjar (Hausarzt | médecin de famille). Ky e njih ecurin personale të sëmundjes dhe është te problemet medicinale personi i parë kontaktues. Për fëmijë ka mjekë dhe mjek të fëmijëve. Nëse është e nevojshme, i udhëzon mjeku pacientët te mjekët specialist në fushë të caktuar apo në spital. Direkt në spital duhet të shkoj njeriu vetëm në raste emergjente të rënda. Për të gjitha emergjencat e tjera, ka jashtë orarit të punës të mjekëve një numër për raste emegjente në kantonin e Bernit. Ky nummer, linjë është 24 orë i hapur 0900 576 747 ( FR.-1.98/min.).

### Mjeku i dhëmbëve

Mjekimi i dhëmbëve sipas rregullit duhet të paguhet vetë. Mirëpo ekziston mundësia, me e bërë një sigurim shtesë, që e mbulon trajtimin e dhëmbëve. Fëmijët që shkojnë në shkollë e kanë të drejtën për kontroll të dhëmbëve një herë në vit. Informacione për këtë jep shkolla.



## Spitali / stacionet për raste emergjente

Kur dikush duhet të shtrihet në spital (Spital | hôpital), në shumicën e rasteve udhëzohet nga një mjek apo mjek. Përjashtim bëjnë aksidentet e rënda, te të cilat njeriu duhet direkt të shtrihet në një stacion spitalor për raste emergjente. Nëse situata është e rrezikshme për jetë apo pacienti duhet të merret, duhet njeriu të thërras në numrin emergjent 144. Te rastet më pak të rënda është mjekja apo mjeku familjar përgjegjës.

## Përkujdesja në shtëpi

Të sëmurit apo nevojtarët për përkujdesje, të cilëve ju nevojitet në shtëpi mbështetje, mund të i marrin shërbimet nga spitali ekstern për përkujdesje ndaj të sëmurëve (Spitex | service de soins à domiciles externes). Personat e arsimuar në fushën përkatëse shkojnë në shtëpi te pacientet dhe pacientët për përkujdesje ndaj tyre, apo me iu ndihmuar në punët e shtëpisë. Kjo ofertë ju drejtohet personave që për shkak të sëmundjes, aksidentit, pleqërisë, komplikimet në shtatzënësi apo pas lindjes kanë nevojë për mbështetje. Pjesërisht mbulohe shpenzimet nga sigurimi bazë (Grundversicherung | assurance de base). Përveç shoqatës spitali ekstern Bern (Spitexverband | association Spitex) ka një numër të madh të ofertuesve privat.

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-bern.ch/sq/shendeti/sherbimit-mjekesore](http://www.hallo-bern.ch/sq/shendeti/sherbimit-mjekesore)